



**Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Oda e Mjekëve të Kosovës**

Në bazë të nenit 23 të Ligjit nr. 4/L-150 për odat e profesionistëve shëndetësorë dhe nenit 20, pika 1.4 të Statutit të OMK-së. Në mbledhjen e mbajtur më 22.6.2017 Kuvendi i OMK-së e miraton:

**RREGULLOREN E PUNËS TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË
ODËS SË MJEKËVE TË KOSOVËS**

Neni 1

1.1 Qëllimi

1.1.1 Me këtë Rregullore përcaktohen procedurat, rregullat, kriteret dhe kompetencat e pavarura të Këshillit Mbikëqyrës të Odës së Mjekëve të Kosovës dhe zbatimit të tyre në praktikë (më tutje në tekst Oda e Mjekëve: OMK)

Neni 2

2.1 Themelimi dhe përgjegjësitë e Këshillit Mbikëqyrës të OMK-së:

2.1.1 Oda e Mjekëve të Kosovës përmes punimeve të Kuvendit të saj të punës themelon Këshillin Mbikëqyrës të OMK-së, nga radhët e anëtarëve të tij, në përbërje të 7 anëtarëve.

2.1.2 Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës votohen përmes anëtarëve të Kuvendit të OMK-së, nga radhët e të cilëve zgjidhen kryetari dhe zëvendëskryetari i Këshillit Mbikëqyrës në pajtim me Rregulloren mbi procedurat e kandidimit dhe mënyrën e zgjedhjes dhe revokimit të anëtarëve të OMK-së

2.1.3 Anëtarët e këtij Këshilli nuk mund të jenë edhe anëtarë të këshillave dhe komisioneve tjera brenda OMK-së.

Neni 3

3.1 Kriteret dhe administrimi i mbajtjes së mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës:

3.1.1 Mbledhjen e Këshillit e udhëheq kryetari, në mungesë të tij e udhëheq zëvendëskryetari.

3.1.2 Nëse ndonjëri nga radhët e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës mungon 3 herë pa arsye në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës të OMK-së, në rast të dorëheqjes së anëtarit të Këshillit, atëherë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, në konsultim me kryetarin e Këshillit Mbikëqyrës, i propozojnë Këshillit Drejtues të OMK-së që përmes Kuvendit të OMK-së të rishikohet përbërja e Këshillit Mbikëqyrës, dhe në këto raste të zgjidhet kryetari dhe anëtari tjetër i Këshillit Mbikëqyrës të OMK-së nga radhët e anëtarëve të vet.

3.1.3 Në mungesë të kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës, me arsye objektive, mbledhjet i mban zëvendëskryetari. Nëse kryetari i Këshillit Mbikëqyrës mungon 3 herë në mbledhje pa arsye, atëherë Këshilli e shqyrton çështjen dhe kërkon largimin e kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës nga pozita e kryetarit, dhe ndjekjen e procedurës sipas Ligjit të OMK-së për zgjedhjen e kryetarit tjetër të Këshillit Mbikëqyrës.

Neni 4

4.1 E drejta e mbajtjes së mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës të OMK-së:

4.1.1 Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës të OMK-së i fton kryetari i Këshillit Mbikëqyrës, së paku 1 herë në muaj, ndërsa të drejtën për të kërkuar mbajtjen e mbledhjes së Këshillit Mbikëqyrës më shumë se 1 herë në muaj, sipas nevojës dhe problematikës së procesit në mbikëqyrjen e proceseve në Odën e Mjekëve të Kosovës, e kanë të drejtën edhe 1/3 e anëtarëve të tjerë të Këshillit Mbikëqyrës të OMK-së.

Neni 5

5.1 Administrimi i mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës të OMK-së:

5.1.1 Administrimin e materialit për mbledhje të Këshillit Mbikëqyrës e përgatit kryetari i Këshillit Mbikëqyrës në konsultim, koordinim dhe bashkëpunim me kryetarin e OMK-së dhe përgjegjësit e sektorit administrativ të OMK-së.

5.1.2 Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të OMK-së duhet të informohen për mbledhje së paku 3 ditë para datës së caktuar të mbledhjes së Këshillit Mbikëqyrës të OMK-së, njëkohësisht materiali për rendin e ditës t'iu shpërndahet anëtarëve të Këshillit 3 ditë përpara mbledhjes.

5.1.3 Në çdo mbledhje të Këshillit Mbikëqyrës nga kryesuesi verifikohet pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës. Për mbajtjen e mbledhjeve të këtij Këshilli duhet të ketë kuorum, së paku 4 (katër) anëtarë duhet të jenë prezentë në të.

5.1.4 Për punën e zhvilluar të mbledhjes së Këshillit Mbikëqyrës mbahet procesverbali, i cili përgatitet brenda 7 ditësh nga mbledhja. Pastaj iu shpërndahet anëtarëve të Këshillit në mbledhjen e radhës, dhe anëtarët e këtij Këshilli kanë të drejtën që të japin vërejtjet e veta në procesverbal të mbledhjes së kaluar, dhe pastaj me vërejtje të plotësuara të miratohet nga anëtarët e KM-së, si dhe të nënshkruhet nga procesmbajtësi dhe kryetari i Këshillit Mbikëqyrës.

5.1.5 Procesverbalet e mbledhjeve ruhen në arkivin e OMK-së.

5.1.6 Këshilli Mbikëqyrës është i obliguar që 1 herë në 6 muaj brenda vitit kalendarik të përpilojë raport pune lidhur me punën dhe aktivitetet e veta, i cili duhet ta miratojë, dhe t'ia paraqesë Këshillit Drejtues të OMK-së dhe Kuvendit të OMK-së.

5.1.7 Mbledhja e komisionit mund të shtyhet ose të ndërpritet në rastet kur nuk ka kuorum, kur mbledhja nuk mund të kryhet në kohën e planifikuar (zgjat shumë).

5.1.8 Mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës e shtyn dhe e ndërpret kryetari i Këshillit.

Neni 6

6.1 Të drejtat e përgjithshme të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të OMK-së:

6.1.1 Të jetë i rregullt në mbajtjen e mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës.

6.1.2 Çdo anëtar ka të drejtë të jetë aktiv në mbikëqyrjen e zhvillimeve të OMK-së.

6.1.3 Të ndërhyjë dhe të marrë pjesë në përpilimin e rregulloreve të OMK-së.

6.1.4 Të marrë pjesë aktive në zhvillimin e aktiviteteve të Këshillit Mbikëqyrës të OMK-së.

6.1.5 Të propozojë pikat e rendit të ditës dhe shqyrtimin e çështjeve të mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës.

6.1.6 Të kërkojë sqarime mbi veprimtaritë e Këshillit Mbikëqyrës.

6.1.7 Të jetë aktiv në proceset e përpilimit të raportit të punës të Këshillit Mbikëqyrës.

Neni 7

7.1 Detyrat specifike të Këshillit Mbikëqyrës të OMK-së:

7.1.1 Mbikëqyr dhe përcjell afarizmin financiar të OMK-së.

7.1.2 Përcjell dhe mbikëqyr realizimin e të drejtave dhe obligimeve të anëtarëve të OMK-së.

7.1.3 Mbikëqyr dhe përcjell punën e shërbimit profesional të OMK-së.

7.1.4 I propozon Këshillit Drejtues marrjen e masave dhe veprimeve në rastet kur vlerëson se ka shkelje ligjore nga anëtarët e OMK-së.

7.1.5 Këshilli Mbikëqyrës i OMK-së për punën e vet i përgjigjet Kuvendit të OMK-së.

7.1.6 Këshilli Mbikëqyrës bashkëpunon me kryetarin e vet, Këshillin Drejtues dhe anëtarët e OMK-së duke respektuar shkathtësitë e komunikimit dhe etikën mjekësore.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hynë në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të OMK dhe nënshkrimit nga Kryetarja e OMK.

Prishtinë

22.06.2017

Kryetarja e OMK

Prof.Dr.Zylfije Hundozi

